

RAPORT

MBI

PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE FONDIT TË KONTIGJENCËS, PËR VITIN 2018

I. Fondi Rezervë

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, buxheti i shtetit përfshin edhe një fond rezervë i cili përdoret për rastet e financimit të shpenzimeve, që nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Gjatë vitit 2018 shuma e Fondit Rezerve të buxhetit të shtetit është miratuar dhe ndryshuar përkatësisht si vijon:

- 1. Ligji nr.109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”** miratoi Fondin Rezervë të Buxhetit të Shtetit në masën **2.7 miliardë lekë**, ku neni 13 përcaktonte përdorimin i tij si mëposhtë:

*Neni 13: Fondi rezervë i buxhetit prej **2 700 milionë lekësh** përdoret nga Këshilli i Ministrave:*

- a) deri në **1 700 milionë lekë**, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore,*
- b) deri në **1 000 milionë lekë**, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.*

- 2. Akti Normativ Nr.1 datë 26.07.2018 “Për disa ndryshime ne Ligjin 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”**, miratoi përdorimin e Fondin Rezervë në masën **2.6 miliardë lekë** si mëposhtë:

*Neni 13: Fondi Rezervë i buxhetit prej **2 600 milionë lekë** përdoret nga Këshilli i Ministrave:*

- a) deri në **1 800 milionë lekë**, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore,*
- b) deri në **800 milionë lekë**, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.*

- 3. Akti Normativ Nr.2 datë 19.12.2018 “Për disa ndryshime ne Ligjin 109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018, të ndryshuar”**, miratoi përdorimin e Fondit Rezervë në masën **1.5 miliardë lekë** si mëposhtë:

*Neni 13: Fondi Rezervë i buxhetit prej **1 500 milionë lekë** përdoret nga Këshilli i Ministrave, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore;*

Deri në datën 31 Dhjetor 2018, Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit është përdorur nëpërmjet **28 Vendimeve** të Këshillit të Ministrave, në shumën prej **1 497.7 milionë lekësh**, nga 1.5 miliard lekë të planifikuara ose në rreth **99.8% përqind** të tij.

Sjellim në vëmendje se, nga 28 VKM-të e miratuara **nuk është bërë akordimi me shkresë** i fondeve **vetëm për VKM-në nr.47 datë 31.01.2018 “Per kompesimin e qirase së banesës për strehimin e prokurorit të caktuar të kryejë për kohësisht detyrën e funksionet e prokurorit të përgjithshëm”** në vlerën **420 mijë lekë**. Kjo pasi, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme nuk u paraqit kërkesa zyrtare për çelje, me argumentin se ky fond është përballuar me fondet e veta buxhetore të Prokurorisë së Përgjithshme, të miratuara për vitin 2018.

Tabela 1: Përdorimi i fondit rezervë për vitin 2018 (në milionë lekë)


Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit 2018	Miratuar me ligj për vitin 2018	Përdorur me VKM gjatë vitit 2018	Mbetur pa përdorur në fund të 2018	Përqindja e përdorimit (Përdorur/Planifikuar)
		1 500	1 497.7	2.335

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Deri në datën 31 Dhjetor 2018, nga fondi rezervë i planifikuar për vitin 2018, i përdorur nëpërmjet VKM-ve, rezultoi se:

- ✓ Rreth 1 117.8 milionë lekë ose 74 përqind e tij, për shpenzime të tjera korrente (shpenzime operative dhe transfertat të brendshme);
- ✓ Rreth 339.45 milionë lekë ose 23 përqind e tij, për investime publike; dhe
- ✓ Rreth 40 milionë lekë ose 3 përqind e tij, janë përdorur për shpenzime personeli.

Grafiku.1 Përdorime të Fondit Rezervë, viti 2018 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Tabela 2: Përdorimi i fondit rezervë 2018, sipas institucioneve përfituese (në 000/lekë)

Kodi instit.	Emërtimi i institucionit	Numri i VKM-ve të miratuara	Fondi i përdorur	
			Vlera (000/lekë)	Në % ndaj përdorimeve
06	Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë	3	179 531	12%
10	Ministria Financave dhe Ekonomisë	9	348 673	23%
12	Ministria e Kulturës	2	58 502	4%
14	Ministria e Drejtësisë	1	120 000	8%
15	Ministria për Europën e Punët e Jashtme	3	96 539	6%
16	Ministria e Brendshme	2	39 792	3%
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	1	35 000	2%
26	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit	3	118 728	8%
28	Prokuroria e Përgjithshme	1	420	-
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1	5 000	-
87	Institucione të tjera Qendrore	3	170 483	11%
00	Bashkia Tiranë	2	324 996	22%
TOTALI			1 497 664	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në mënyrë analitike rezulton se:

- ✓ Rreth 348.7 milionë lekë, ose rreth 23 përqind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet nëntë vendimeve, si shtesë fondi në planin e buxhetit të vitit 2018 për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar, për një shtesë fondesh, nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratuar për vitin 2018, dhe rishpërndarje të fondit të pagave për DPT, ku janë shtuar fonde për investime, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në gjykatat italiane", për subvencionimin e Dhomës Kombëtare të Zejtarisë, për autorizimin e Ministrisë së Brendshme dhe MFE për lidhjen e kontratës me kompaninë Ernst&Young.
- ✓ Rreth 324.9 milionë lekë ose 22% e fondit rezervë i janë akorduar Bashkisë Tiranë, nëpërmjet dy vendimeve për shpronësime.
- ✓ Rreth 179.5 milionë lekë ose rreth 12 përqind e fondit rezervë të përdorur gjatë vitit 2018, i është dhënë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet tre vendimeve. Në dy prej tyre janë akorduar fonde për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin e mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar dhe me një VKM janë akorduar fonde për Autoritetin e Mediave Audiovizive.
- ✓ 170.4 milionë lekë i janë akorduar institucioneve të tjera qeveritare dhe konkretisht: 75 milion lekë Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të vitit të Skënderbeut, dhe 95 milion lekë i janë akorduar AKSHI-t.
- ✓ 120 milion lekë ose 8 përqind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Drejtësisë, për investime, për rikonstruksionin dhe përshtatjen e ambjentëve ku do të ushtrorjnë aktivitetin kolegjial posaçëm I apelimit dhe komisionerët publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH"
- ✓ Rreth 118.7 milionë lekë ose 8 përqind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet tre vendimeve. Me një vendim është akorduar fondi prej 35 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve për punonjësit me kontratë. Me një vendim tjetër është akorduar 80.9 milionë lekë për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar. 2.8 milionë lekë është akorduar për pagesën e kuotave të organizatave ndërkombëtare.
- ✓ Rreth 96.6 milionë lekë ose 6 përqind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nëpërmjet tre vendimeve . Në një vendim është akorduar 80.4 milionë lekë "Për autorizimin e ministrise për Evropën dhe punët e jashtme për lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë "Apco Eorldeide". Në një vendim tjetër është akorduar shuma 12.9 milionë lekë për dhënien e ndihmës financiare nga KM për qeverinë e Greqisë, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga zjarret masive në korrik 2018. Shuma prej 3.2 milionë lekë është akorduar për përballimin e shpenzimeve për kthimin në atdhe të eshtrave të personalitetit të shquar të letrave shqipe dhe të kulturës mbarëkombëtare Mid'hat Frashëri".

- ✓ Rreth 58.5 milionë lekë ose 4 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Kulturës, nëpërmjet dy vendimeve. Në një vendim është akorduar shuma për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve si pjesë e kalendarit të vitit 2018 si viti mbarëkombëtar i GJ.K.Skënderbeut, dhe vendimi tjetër ka akorduar fondin prej 6.3 milion lekë për pagesën e kuotave të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.
- ✓ Rreth 39.7 milionë lekë ose 3 për qind e fondit rezervë i është dhënë Ministrisë së Brendshme nëpërmjet dy vendimeve. Me një vendim është akorduar fondi prej 39 milion lekë për investime për për blerje të automjeteve për prefektet e qarqeve. Me një vendim tjetër është akorduar shuma prej 792 mijë lekë për ndihme financiare znj Ina Gavrosh Nuka, inspektor, punonjes policie.
- ✓ 35 milion lekë ose 2 për qind e fondit rezervë i është akorduar Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për projektet dhe aktivitetet në kuadër të vitit mbarëkombëtar të GJK-Skenderbeut.
- ✓ Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar 5 milionë lekë për përballimin e shpenzimeve për hapjen e kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore të zgjedhjeve për KSH të dt 25.06.2017 zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kavajë dhe zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të B.Kolonjë"

Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën 31 dhjetor 2018, gjendja e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, e papërdorur, rezulton të jetë 2.33 milionë lekë.

II. Fondi Kontigjencë

Fondi Kontigjencë për risqet e borxhit, në masën prej 4 miliardë lekë, është miratuar sipas nenit 13 të Ligjit nr.109 datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018, i ndryshuar", ku përcaktohet se: "...Kontigjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekë, përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit...".

Në datën 31 Dhjetor 2018, kjo kontigjencë rezulton e papërdorur.